

Aktakuza e Ngritur ndaj ish-imamit të Xhamisë së Madhe në Prishtinë, Shefqet Krasniqit, ka ngjallur reagime të shumta.

Qytetarët, hoxhallarët, analistët, por edhe Bashkësia Islame e Kosovës, kanë vlerësuar se aktakuza e ngritur ndaj hoxhë Shefqet Krasniqit është e pabazë dhe e paargumentuar.

Në këtë video të realizuar qytetarët i japin mbështetje të fuqishme hoxhës Shefqet.

Po ashtu edhe hoxha Fatmir Latifi dhe zëdhënësi i BIK-ut Ahmet Sadriu vlerësojnë se kjo arsye e ngritjes së aktakuzës nuk qëndrojnë, ngase vlerësojnë se hoxha në fjalë nuk ka thirrur asnjëherë që të shkohet në vatrat e luftës dhe se ligjërtatat e tij nuk shpërfaqin nxitje të urrejtjes./mesazhi/